

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës Komora inženjera Republike Kosovo Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo	
Njësia org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.
Nr. i faqeve Br. Stranica Nr. Pages	Data: Datum: Date:
PRISHTINË / A	No.1



**ODA E INXHINIERËVE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

*Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Inženjerska komora Republike Kosova
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo*

Në përputhje me nenin 26 të Ligjit Nr. 08/L-012 për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, nenin 27 të Statutit të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës për periudhën e përkohshme, të miratuar më datën 31.12.2024, me numër protokolli 8648/24; dhe Rregullores për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjes, Pezullimit dhe Revokimit të Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës, të miratuar më datën 31.12.2024, me numër protokolli 8651/24, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 22.09.2025, merret:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me nr. protokolli 696/2025, e datës 15.08.2025, e paraqitur nga Erdoan Zasella, i lindur më 08.06.1996 në Mitrovicë, me kualifikim akademik Master i Shkencave të Inxhinierisë Mekanike, programi Mekanikë, kundër vendimit me nr. protokolli 657/2025, të datës 06.08.2025, të Komisionit Vlerësues, konform dispozitave ligjore në fuqi, përkatësisht nenit 26 të Ligjit Nr. 08/L-012 dhe neneve 5 dhe 8 të Rregullores për Licencim.

Arsyetim

Aplikuesi Erdoan Zasella, i lindur më 08.06.1996 në Mitrovicë, me nr. protokolli 1685/2023, ka dorëzuar aplikacionin me dokumentacionin e nevojshëm për licencim. Pas vlerësimit të dokumentacionit dhe shqyrtimit të kërkesës, në përputhje me nenin 10 të Rregullores dhe ligjit në fuqi, Komisioni Vlerësues ka konstatuar se aplikuesi nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në nenet 5 dhe 8 të Rregullores për Procedurën e Licencimit, Rilicencimit, Mirëmbajtjes, Pezullimit dhe Revokimit të Licencës së Inxhinierit të Licencuar të Odës, si dhe të ligjit në fuqi, gjegjësisht nenit 26, paragrafi 7. I njëjti nuk posedon përvojën profesionale në fushën e ndërtimit, sipas kërkesës së rregullores së përmendur më lart. Kundër vendimit me nr. protokolli 657/2025, datë 06.08.2025, të Komisionit Vlerësues, Erdoan Zasella ka paraqitur ankesë me nr. protokolli 696/2025, datë 15.08.2025. Në këtë ankesë, sipas tij, bazuar në të dhënat nga Trusti, si dhe dokumentin "Kartela e Punës" nga KEK-u, pas diplomimit në nivelin Master më 27.06.2023, ka ushtruar këto funksione në Korporatën Energjetike të Kosovës:

- Deri në 08/2023 – Inxhinier përgjegjës i elektrikës në Termocentralin Kosova A
- 08/2023 – 03/2025 – Menaxher i Departamentit të Burimeve të Ripërtëritshme
- 03/2025 – vazhdon – Drejtor Ekzekutiv i Divizionit të Burimeve të Ripërtëritshme

Gjithashtu, në CV është e qartë se paralelisht me këto funksione ka ushtruar edhe detyrën e menaxherit të projektit fotovoltai 100 MW **SOLAR4KOSOVO**, projekt i KEK-ut, KfW, EIB dhe Bashkimit Europian. Ky projekt, i cili është në zhvillim e sipër, përbën punën kryesore të Divizionit të BRE-ve në KEK.

Siç dihet, projekti fotovoltai është projekt për gjenerimin e energjisë elektrike, pra ka lidhje të drejtpërdrejtë me fushat e energjisë elektrike dhe mekanike.

Komponentët përbërës të këtij projekti – si panelet diellore, kabllot, konvertimi DC në AC përmes invertorëve, transformimi i tensionit në nivel transmissi për lidhje me KOSTT, linjat dhe transformatorët – përbëjnë një gamë të plotë teknologjish dhe komponentësh që rrallëherë mund të gjenden të bashkuara në një vend pune, duke ofruar një përvojë të veçantë inxhinierike, siç aplikuesi pretendon se ka pasur fatin ta fitojë.

Megjithatë, lidhur me këto pretendime të palës, gjegjësisht të Erdoan Zaselës, vlerësohet se Komisioni Vlerësues ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi, përkatësisht nenit 26, paragrafi 7 të Ligjit Nr. 08/L-012 dhe neneve 5 dhe 8 të Rregullores për Licencim. Andaj, ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i Komisionit Vlerësues me nr. protokoll 657/2025, datë 06.08.2025, po ashtu konform nenit 10, paragrafi 8 të Rregullores për Licencim.

Duke u bazuar në ankesën dhe dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi Erdoan Zasella, Komisioni i Ankesave vendos në përputhje me dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë juridike


Pala e pakënaqur ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës kompetente kundër vendimit të Komisionit të Ankesave të OIRK-së brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Palës;
- Komisionit të Ankesave;
- Administratës së OIRK-së.

Komisioni i Ankesave:

Ekrem Sallahaj, Anëtar



Petrit Hajrizi, Kryesues



Bekim Ahmeti, Anëtar

